



REPUBLIKA E KOSOVËS


REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E SHTIMES

MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESEDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE



ZYRA PËR INFORMIM/ INFORMATION OFFICE/ KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

Procesverbali nga Debati Publik me Qytetar për **Draft-Programin Strategjik për Ujërat në Komunën e Shtimes**, i mbajtur me datë 23 Janar 2024, në ora 14, në Sallën e Kuvendit

Në cilësinë e Panelistëve ishin: Nënkryetari i Komunës z. Faruk Beqa, Konsulenti jashtëm nga Organizata SDK z. Besnik Muçaj dhe Muhamet Qeriqi nga organizata SDK.

Pjesëmarrës tjerë ishin përfaqësues nga sektori i shoqërisë civile dhe disa qytetarë.

Takimi është hapur nga Nënkryetari i Komunës së Shtimes z. Faruk Beqa.

Faruk Beqa – Përshëndetje të gjithëve, ju falenderoj për pjesëmarrjen e juaj në këtë takim. Siç jeni edhe ju të informuar ky është takim që ka për qëllim diskutimin me qytetarë për Programin Strategjik për Ujërat në Komunën e Shtimes. Këtu me ne është z. Besnik Muçaj dhe z. Muhamet Qeriqi të cilët janë përfaqësues të organizatës Sundimi i Demokracisë në Kosovë me të cilët Komuna e Shtimes ka nënshkruar një marrveshje bashkëpunimi për të bashkë-hartuar një Program Strategjik për Ujërat në Komunën e Shtimes. Është formuar Grupi Punues dhe kanë filluar takimet, janë mbajtur dikun 4 takime/punëtori. Për më shumë detaje rreth përmbajtjes së dokumentit i'a kalojmë fjalën Konsulentit z. Besnik Muçaj. Edhe një informacion para se të bëhet prezantimi: Ky Draft Dokument është dal edhe në Kuvend, i cili e ka nxjerrë në diskutim publik dhe pas këtij diskutimi do të kaloj përsëri në Kuvend për miratim. E kalojmë fjalën tek Besniku.

Besnik Muçaj - Faleminderit nënkryetar, faleminderit edhe për ju pjesëmarrës që keni ndarë kohën me qenë në këtë takim sëbashku me ne. Vlen të theksohet se Komuna e Shtimes është e para e cila po harton një Program Strategjik për Ujërat. Ky dokument nuk nxjerr obligime të veçanta për komunën, është një dokument që strukturon veprimet dhe dokumentet strategjike, politikat dhe financimet komunale sa i përket mbrojtjes së ujrave. Të gjitha veprimet kanë korrelacion, kanë ndërlidhje të drejtëpërdrejt me dokumente tjera strategjike dhe veprimeve tjera komunale. Secili prej veprimeve nxjerr obligime, nxjerrë të sakta veprimet që duhet të derivojnë qoftë në projektim të investimeve të reja kapitale, qoftë në planifikim të kornizave afatmesme buxhetore për projektet që janë më shumë se një vit apo qoftë edhe refleksione në dokumente tjera siç janë Plani i Rreziqeve Komunale edhe nuk ndalet vetëm me kaq duke marrë parasysh edhe kontekstet komunale edhe ndërvashmërinë me akter tjerë siç janë Ujësjells, Ndërmarrjet Publike Lokale, Rajonale.

Është e vlefshme të theksohet se objektivi i vet kësaj Strategjie është dokument që përmbledh obligimet, synimet, veprimet e dokumenteve në këtë fushë e që i kthen në pikësynim për mbrojtjen e ujërave.

Albulena Emimi – Përshëndetje për të gjithë. Unë e kam përcjellë me vëmendje punën e kësaj Strategjie, njëherit kam qenë edhe anëtare e grupit punues. Besoj dhe shpresoj se ka me qenë një dokument shumë i përdorshëm, marrë parasysh se komuna e Shtimes është shumë me fat që e ka një lum, ndoshta është edhe shumë me fat nëse bën përpjekje me ruajt këtë resurs natyror. Kuptohet që secila e mirë e ka edhe një anë të keqe apo më mirë me thanë si dobësi, marrë parasysh që ndoshta në të kaluarën i është kushtuar shumë pak vëmendje në këtë rast të ujrave. E mira e kësaj Strategjie, konkretisht SWOT Analizës neve naj tregon rrugën se se kah duhet me shku na në të ardhmen. Çështja e vërshimeve marrë parasysh që jam edhe pjesë e Komisionit për fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera. Vitin e kaluar kemi pas shqetësime të qytetarëve sa i përket vërshimeve në dëme të kulturave bujqësore. Kishte me qenë mirë që këtu të paktën me u specifikuar, psh. cilat kishin me qenë hapat që institucioni jonë duhet me i marrë? Ne duhemi me u fokusuar se cila ka me qenë strategjia që institucioni jonë ka me përdor për me zgjedh në mënyrë permanente, sidomos në pjesën e rrafshit të terenit të Shtimes. Faleminderit për vëmendje.

Besnik Muçaj – E para, ky dokument Strategjik jep indikacione, nxjerrë detyra, po edhe krijon një udhëpërshkrim edhe për dokumente tjera. Synimi kryesor ka qenë ky. E dyta, nuk jemi ndal vetëm në praktikat aktuale që funksionojnë në komuna që veprojnë vetem add hock. Kemi provu me kriju një qasje ma të integruar të menaxhimit të ujrave duke i ndërlidh të gjitha politikat sektoriale. Kjo Strategji reflekton, nisur nga vetëdijësimi publikut, takimet me banorë në atë pjesë deri tek masat në menaxhimin e mbeturinave, përfshirjen në sistemin e grumbullimit të tyre e deri tek masat afirmative dhe ndëshkuese. Pra, ndërlidhen edhe me sensin e mbrojtjes së tokave bujqësore por edhe ushqimeve. Pra, ka një reflektim shumë më të gjerë në sensin organizativ por edhe në sensin menaxherial, procedural e financiar sa i përket menaxhimit të ujrave.

Albulena Emimi – Unë jam person i terenit dhe i shoh problematikat. Fatkeqësisht Komuna jonë ende nuk e ka një hapësirë të caktuar të kryerjes së therrjes së kafsheve pavarësisht komuniteteve fetare. Ne i kemi edhe disa sfida që është deponitë ilegale të mbeturinave inerte e që është sfidë sepse ne si komunë ende nuk kemi një lokacion të caktuar.

Sfidë për rrjedhën lumore është çështja e marrjes së inerteve në mënyrë të pakontrolluar, prej individëve të cilët ndoshta e shohin si profitabile çështjen e resurseve që nxjerrren prej lumit. Sfidë tjetër është edhe marrja në shfrytëzim e burimeve, krojeve nga persona jo kompetent të cilët nuk kanë asnjë dokumentacion që i'a njeht të drejtën e shfrytëzimit të një resursi ujor e që në këtë rast ndikon shumë në rrjedhën lumore.

Këto janë disa problematika që ne si institucion duhet me i trajtu.

Besnik Muçaj – Pikërisht këto të cilat u cekën janë të përfshira në këtë dokument në kuadër të masave të përcaktuara, për aq sa lejojnë kompetencat e nivelit local.

Xhevat Tërshana – Ju përshëndes të gjithëve. Une isha ndal pak tek mbeturinat, Kjo anomali është ka na proekupon qysh nga pas luftës, qytetarët i hudhin mbeturinat edhe në lum. Në komunën e Shtimes ka ende ekonomi familjare që nuk paguajnë mbeturinat dhe sipas pasajë ndotet lumi nga mbeturinat. Do duhej që të ndërmerren masa në këtë drejtim


Behadin Rexhepi – Përshendetje të gjithëve, është mjaft i rëndësishëm ky takim, ku ne mund të japim kontributin tonë në këtë drejtim. Ne e dim që të gjitha ujërat e zeza derdhen në lum, për çdo ditë ndodh kjo. Vetëdija jonë është e ulët në këtë drejtim. Shtrati i lumit në vazhdimësi ngushtohet nga mbjellja e shelnjeve në pronat private. Faktori njeri është shkaktari kryesor pse ndodhin vërshimet, për arsye se po degradohen lumenjtë. Do duhej të merren masa për vetëdijësimin qytetarë. Kjo do duhej të ndodh që nga edukimi i hershëm, në mënyrë që të vetëdijësohemi si shoqëri.

Faruk Beqa – Në këtë dokument ka objektiva dhe masa të cilat duhet të ndërmerren. U përmendën çështjet e ujrave të zeza, të gjitha trajtohen në këtë dokument. U përmend uzurpimet mbjelljet, këtu ka të bëjë edhe me masat që duhet mu ndërmarrë si komunë si institucione por njekohësisht edhe vetëdijësim, edhe e kemi problemin e hudhjes së mbeturinave. Në Shtime janë diku 4,800 ekonomi familjare, ata kanë obligim me ligj me shku me i marrë mbeturinat në secilën familje me ba kontratë edhe në raportet që i kam pa unë në shumicën e fshatrave janë dikun 50% nuk kanë kontratë dhe jemi dëshmitarë që në kohrat me reshje shiu lumi mbushet me mbeturina të hedhura. Këtu duhet me shku me fol me qytetarë që të binden për hyrjen në sistem. Kjo do duhej të bëhet edhe nga ana e kompanisë. Ne si komunë jemi në fazën e themelimit të një kompania komunale të cilës mund ti jepen detyra, jo vetem pastrami i mbeturinave, grumbullimi në institucione edhe ekonomi familjare, por aty mund të kyçen edhe bizneset private. Përmes kësaj Strategjie duhemi të fokusohemi edhe në këtë çështje.

Besnik Muçaj – Faleminderit shumë për kontributin e juaj. Të gjitha këto çështje të cilat u ngritën nga ju, ne si grup punues do t'i shqyrtojmë dhe do të i inkorporojmë në këtë dokument dhe si dokument final e përcjellim për miratim në Kuvendin Komunal. Faleminderit edhe një herë për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë. Këtu e mbyllim diskutimin publik.

Mbledhja përfundoi në ora 15:24

Procesmbajtës:
Vlora Hyseni





Diskutim Publik
 “Draft Strategjia dhe Plani Veprimi për mbrojtjen e ujërave në Komunën e Shtimes”

23 Janar 2024, Shtime

No	Emri dhe Mbiemri	Institucioni/Organizata	Vendi	Nr. i telefonit	Email	Nënskrimi
1	Muhamet Mehmet	OJG - ASU	SHTIME	048-709342	muhametmehmeti@ojg-kuva.com	M Mehmet
2	Mazir Hyoani	qytetar	Gjodanc	044 973 068	mazir.hyoani@gmail.com	M Hyoani
3	Ali Ademaj	KRUJA PRIMITIVE	Shtime	044/201 926	ali.ademaj@gmail.com	A Ademaj
4	Mevlat Lerdhona	DK Komitete Liplan	Shtime	044/208 883	mevlad.erdhona@hotmail.com	M Lerdhona
5	BASRI MIKULLORI	ZVICERR	GJODANC IP.	044/205 746		B Mikullori
6	Mehel Rustiti	QPS në Shtime	Shtime	044/421-018	mehel.rustiti@qps-kuva.com	M Rustiti
7	Behadin Pashaj	QYTEM	SHTIME	044 207-982	behadin.pashaj@qytem.com	B Pashaj
8	Tofil Haxho	Pullkaria	Shtime	044/368-426	tofil.haxho@gmail.com	T Haxho
9	Donjeta Gorrelli	Zyra për Informim	Shtime	049/185/245	donjeta.gorrelli@gmail.com	D Gorrelli
10	SANIJE SADIKI	KESHILLI QYLLOR KOMUNALE	SHTIME	044/835 1074	sanije.sadiki@gmail.com	S Sadiki
11	Olona Hyseni	Zyra për Informim	Shtime	044/389-410	olona.hyseni@qps-kuva.com	O Hyseni
12	Albulenë Emini	INSPEKTORAT	SHTIME	044/722-734	albulena.emini@insp-kuva.com	A Emini
13	Memorin Robani	DSTP	SHTIME	043-517791	memorin.robani@dstp-kuva.com	M Robani
14	Shenize Dauti	ZMJA	Arbore	044-172-839	shenize.dauti@zmja-kuva.com	S Dauti
15	FARUK BEGA	Zyra Shtrite	SHTIME	045 690 168	faruk.bega@zsh-kuva.com	F Bega

